



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr.16

Prishtinë, më 4.5.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Valentina Bunjaku – Rexhepi, Fidan Rekalju, Nezir Çoçaj, Abdyl Salihu, Adem Mikullovc, Arbërie Nagavci dhe Verica Çeraniq.

Munguan: Mufera Shinik dhe Albulena Balaj – Halimaj.

Përfaqësues të tjerë: përfaqësues nga MASHT, përfaqësues të Trashëgimisë Kulturore, përfaqësues të KDI-së dhe mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.4.2018 dhe 13.4.2018;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99;**
- 4. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen, sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.4.2018 dhe 13.4.2018

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 10.4.2018 dhe 13.3.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtim në parim i projektligjit numër 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990-91 deri në vitin shkollor 1998-99

Ismajl Kurteshi, tha se projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës, nga viti shkollor 1990-91 deri në vitin shkollor 1998-99, u është shpërndarë deputetëve të Kuvendit. Sipas Rregullores së Kuvendit, komisioni duhet ta shqyrtojë në parim dhe t'i paraqesë Kuvendit rekomandim për miratim, para shqyrtimit të parë në seancë plenare. Po ashtu, tha se do të bëhet shqyrtimi i projektligjit në afatet më të shkurtra kohore, që i lejojnë procedurat e Kuvendit, pra ne mund ta dërgojmë projektligjin në seancë për miratim, vetëm pasi të kenë kaluar dy javë që është në duart e komisionit.

Heset Sahiti, zëvendësministër i MASHT, prezantoi në mënyrë të përgjithshme Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës, nga viti shkollor 1990-91 deri në vitin shkollor 1998-99. Ai theksoi se qëllimi i hartimit të këtij projektligji është njohja dhe përcaktimi i të drejtave, lidhur me përfitimet e punëtorëve të punonjësve të arsimit, që kanë punuar nga viti 1990/91 deri në vitin 1998/99. Përcaktimi i statusit dhe njohja e stazhit të punës përmes përkrahjes financiare për mësimdhënësit, punëtorët profesionalë, personelin menaxhues, administrativ dhe teknik të shkollave dhe universiteteve të Prishtinës. Ky projektligj, sipas Sahitit, është i rëndësishëm së veçantë, për gjithë sistemin e arsimit shqip në Kosovë, duke marrë në konsideratë kontributin e pakompensuar të mësimdhënësve të atyre viteve.

Gjithashtu, Alush Istogu bëri të ditur se përmes këtij ligji synohet të përfitojnë dy kategori të punonjësve të viteve të 90-ta: kategoria e parë e mësimdhënësve që kanë punuar prej 5 deri në 10 vite, llogaritet një pagë shtesë prej 75% nga paga mesatare. Ndërkaq, kategoria e dytë e mësimdhënësve që kanë punuar nga 1 deri në 5 vite, llogaritet 65% e pagës bazë.

Adem Mikullovci, shprehu dyshimet e tij, lidhur me kontributin që do të paguhet. Ai tha se nuk e kishte të qartë se a është duke u kërkuar kontributi për 9 vite apo në mënyrë retroaktive po kërkohet që ky kontribut të paguhet për 9 vite për të gjithë arsimtarët, për shkak që sipas tij ekziston rreziku të ndodhë e njëjta, si me veteranët e luftës.

Heset Sahiti, sqaroi që nuk paguhen borxhet të cilat ju kanë mbetur atëherë punëtorëve mirëpo kjo fillon si njëfarë lloj kompensimi / mirënjohje për mësimdhënësit që nga koha kur dalin në pension.

Teuta Haxhiu, tha që mësimdhënësit nuk kanë nevojë për një mirënjohje, sepse mirënjohjen e kanë marrë nga populli, si mësimdhënës të asaj kohe. Ata kanë nevojë t'iu vlerësohet dinjiteti i atyre që kontribuuan në arsimin shqip gjatë një periudhe aq të vështirë. Ajo theksoi, gjithashtu, se do të bëhen përpjekje maksimale për të hartuar një ligj, i cili do të jetë i zbatueshëm dhe në interes të mësimdhënësve, duke u gëzuar për rolin dhe ndikimin që ka komisioni në këtë projektligj.

Arbërie Nagavci, shprehu mirënjohjen e saj për këtë projektligj. Ajo tha se ka shumë gjëra që duhet diskutuar në mes të dy leximeve dhe që do të bëjnë përpjekje, që në kushte të përshpejtuara, ta dërgojnë në Kuvend. Nga ana tjetër, ajo kërkoi sqarime rreth shifrës së saktë që këta mësimdhënës do të përfitojnë, si dhe kërkoi të sqarohet e drejta për këtë përfitim te personat, të cilët nuk jetojnë më.

Alush Istogu, shpjegoi që kategoria e parë apo mësimdhënësit që kanë punuar 5 deri në 10 vite, do të marrin 63 euro e 75 cent, ndërsa kategoria e dytë, mësimdhënësit që kanë punuar 1 deri në 5 vite, do të përfitojnë 23 euro e 30 cent. Kjo vlen vetëm nga momenti që ky ligj miratohet. Gjithashtu, ai theksoi se për të gjithë ata mësimdhënës që kanë dhënë kontributin e tyre, por që nuk jetojnë më, bashkëshortja ose fëmijët e tyre kanë mundësi ta gëzojnë këtë të drejtë.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, gjithashtu theksoi se projektligji është më se i mirëseardhur, duke thënë se ky projektligj nuk ofron mundësi për politik-bërje, por që komisioni duhet të fokusohet në çështjet teknike. Ajo tha se mësimdhënësit e asaj kohe janë heronj të këtij shteti dhe ajo çfarë na mbetet neve është të votojmë pro këtij projektligji. Nga ana tjetër, ajo tha se sa i përket trashëgimisë, të drejtën e trashëgimisë mund ta gëzojnë fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, e jo deri në moshën 26, në mënyrë që të ulët kostoja buxhetore dhe të mos ndodhë e njëjta, si me listat e veteraneve, sepse ulët vlera e atyre që njëmend kanë kontribuar dhe që kjo kategori duhet të jetë politikisht e paprekur.

Nezir Çoçaj, shprehu gjithashtu gatishmërinë e tij dhe grupit të tij parlamentar për të mbështetur jetësimin e këtij projektligjit. Ai tha se shteti që po e gëzojmë sot, përveç dëshmorëve, është meritë shumë e madhe edhe e atyre që mbajtën arsimin gjallë. Ai theksoi se të gjithë ata që kanë kontribuar në shtetëzimin e Kosovës e kanë këtë të drejtë, mirëpo që askush nuk mund të barazohet me kontribuuesit e arsimit shqip.

Ismajl Kurteshi, pas përfundimit të diskutimeve nga ana e deputetëve, ftoi anëtarët e komisionit të votojnë që ky projektligj të kalojë në Kuvend për lexim të parë, duke shtuar se do të bëhet përpjekje maksimale nga ana e komisionit, për të provuar jetësimin e këtij projektligji. Pas diskutimeve, komisioni, me shumicë votash, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017

Shafi Gashi, lidhur me raportin e punës të KKTK për vitin 2017, foli për sfidat dhe vështirësitë e KKTK-së. Ai tha se në përgjithësi ka progres, mirëpo krahasuar me nevojat që ka ky Këshill, gjendja është jashtëzakonisht e keqe. Gjithashtu, ai përmendi faktin që ka pasur progres tek administrata dhe për shkaqe të implikimeve buxhetore kanë kaluar nga një objekt me qira në kontejner. Ankesat e tij ishin se mungonte bashkëpunimi në mes të KKTK-së dhe Departamentit të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ai theksoi se ka një mungesë të theksuar të stafit shkencor, si dhe ata të cilët janë aktualisht, paguhen shumë pak. Ai vazhdoi me shqetësimet e tij, duke thënë se instituti që merret me trashëgimi arkeologjike është lënë në ligj si institucion kompetent, mirëpo që nuk është e potencuar si duhet dhe kjo e metë duhet të përmirësohet me ligjin e ri. Më tej, shtoi se lejet për gërmime nuk duhet të lëshohen nga çdo institucion, por që duhet të ketë një lloj kriteri. Në fund, ai i bëri thirrje komisionit për kthimin e koleksionit të vitit 1999, duke potencuar se i takon këtij vendi.

Ismajl Kurteshi, tha se ky raport përfshin më shumë ankesa, sfida, vështirësi e shumë pak punë, e cila është bërë gjatë vitit, për të cilin Këshilli duhet të raportojë. Ai, gjithashtu, theksoi faktin që shumica e të dhënave të paraqitura në raport janë të njëjta me të dhënat e paraqitura në raportin e vitit të kaluar, siç janë rastet e kopjimit të ligjeve të ndryshme e të vendosura në këtë raport. Kompetencat e KKTK-së janë të përcaktuara qartë me ligj, duke ua bërë me dije rolin dhe ndikimin që e kanë si Këshill, e që nuk janë shfrytëzuar siç duhet.

Teuta Haxhiu, shprehu zhgënjimin e saj mbi punën e KKTK-së, duke thënë se ka qenë shumë optimiste që ky Këshill ka një ekip profesional. Duke qenë se Komisioni për Arsim shërben si urë lidhëse në mes të Këshillit dhe ministrive / institucioneve përkatëse, ju si Këshill nuk keni adresuar asnjëherë shqetësimet tuaja.

Arbërie Nagavci, tha se është e çuditshme mungesa e bashkëpunimit mes këtyre dy institucioneve. Përpos volumit edhe për nga përmbajtja, ky raport ka shumë të meta. Gjithashtu, tha se është shumë e vështirë për ne, si komision, t'iu ndihmojmë kur ju keni potencuar sfida dhe vështirësi shumë të përgjithshme.

Verica Çeraniq, tha se sa i përket gjendjes së trashëgimisë kulturore, vërehet se raporti fokusohet në periudhën e para luftës, përkatësisht periudhën 1998 – 1999 dhe precizohet se në luftë është shkatërruar kryesisht trashëgimia kulturore jo serbe, përkatësisht rreth 200 xhamia. Ndërkaq, në raport injorohen shkatërrimet e përmasave të mëdha që kanë ndodhur pas luftës ndaj monumenteve kulturore serbe, kryesisht të karakterit fetar ortodoks, me ç'rast ka pësuar një numër i madh i kishave serbe, manastireve dhe objekteve të tjera të kishës ortodokse serbe.

Po ashtu, tha se pas 19 viteve të përfundimit të konfliktit, nuk duhet të injorohen këto rrënime të pasluftës, e veçanërisht që këtë ta bëjë një institucion, që merret me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në raport flitet për renovimin e monumenteve ortodokse, pas dëbimit të vitit 2004. Këto monumente janë rinovuar nga mjetet e komunitetit ndërkombëtar, të cilat kanë kaluar përmes buxhetit të Kosovës. Qasja për këto objekte e monumente kulturore është e rregulluar me Ligjin për liritë fetare, si dhe me Ligjin për zonat e mbrojtura.

Në këtë raport nuk flitet lidhur me veprimet ndaj kishës në qendër të Prishtinës, ku institucionet kompetente lejojnë qasjen në këtë objekt, ndërsa individët e papërgjegjshëm madje inkurajohen që ta shkatërrojnë këtë tempull. Raporti nuk është marrë me sulmet ndaj pelegrinëve serbë në Pejë dhe Gjakovë, pengimin e vizitave në objektet kulturore të rëndësisë së veçantë, njëri prej të cilëve është në mbrojtje të UNESCO-s. Në raport nuk përmendet gjendja, në të cilën gjenden varrezat ortodokse në Kosovë, si dhe arsyet për të cilat gjenden këto varreze në këtë situatë dhe askush në Kosovë nuk është përgjegjës për shkatërrimin e varrezave ortodokse. Më tej, tha se si anëtare e komisionit nga radhët e Listës Serbe, nuk e përkrah raportin e punës të Këshillit për Trashëgiminë Kulturore, të njëjtin e konsiderojmë raport të njëanshëm.

Adem Mikullovc, theksoi se raporti është shumë i cekët, sidomos te pjesa e trashëgimisë shpirtërore, të cilën ai e konsideron si shumë të vështirë për ta ruajtur.

Pas diskutimeve, anëtarët e komisionit u pajtuan që votimi për raportin e punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017, të bëhet në mbledhjen e radhës.

5. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,
Ismajl Kurteshi